REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr.3073/10 Prot. Vlorë më, 04.11.2026

VENDIM
Nr.70, datë 04.11.2026

PËR

HAPJEN E PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, BACHELOR NË "E DREJTA DHE QEVERISJA DIGJITALE", NË GJUHËN SHQIPE DHE NË GJUHËN ANGLEZE, PËR VITIN AKADEMIK 2027–2028, NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË

Në mbështetje të nenit 25, pika 7, nenit 35, nenit 38, pika 1, shkronja "dh", dhe nenit 75 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar; të Udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar; të nenit 10, pika 6, nenit 19, pika 1, shkronja "ë", dhe nenit 59 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; të nenit 13, pika 22, nenit 55 dhe nenit 69 të Rregullores së Brendshme të Universitetit; si dhe referuar relacionit të Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmësakademike, përcjellë me shkresën nr. 2995/1 prot., datë 04.11.2026, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 04.11.2026,

VENDOSI

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Shkencave Humane për hapjen e programit të ri të studimit të ciklit të parë, "Bachelor në E Drejta dhe Qeverisja Digjitale", në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, për vitin akademik 2027–2028, në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, sipas materialit bashkëlidhur, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektori Akademik, Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakademike dhe Fakulteti i Shkencave Humane.
3. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËN KRYETAR I SENATIT AKADEMIK
Prof. Asoc . Denada Sota

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORË

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al